

RELACION

“PËR

PROJEKTLIGJIN PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE PËR SHMANGIEN E TATIMIT TE DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN”.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”, është mbështetur në nenet 78 dhe 83 pika 1 dhe 121, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin krijon një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve apo personave juridikë shqiptarë apo sauditë, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të ardhura të tjera që janë objekt i legjislacioneve tatimore të të dy shteteve.

Duke patur aktivitet në të dy shtetet apo duke qenë rezident i njerit shtet që siguron të ardhura në shtetin tjetër, individ i apo personi juridik mund të rëndohet me tatim të dyfishtë (për të njëjtën të ardhur të tatohet dy herë) gjë që mund të krijojë premisa për shmangie të tatimit dhe evazion fiskal.

Kjo Marrëveshje, trajton pikërisht faktin se si do të shmanget tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njerit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

Marrëveshja gjithashtu, ka dispozita në bazë të të cilave shtetet kontraktuese shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë për parandalimin e evazionit fiskal për subjektet që kanë aktivitet në të dy vendet.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME

Relacion shpjegues për projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin

PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Marrëveshjet (Konventat) për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal kanë një rol të rëndësishëm në kompleksin e faktorëve që garantojnë, favorizojnë dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërkombëtare.

Rëndësia e këtyre marrëveshjeve po rritet vazhdimisht në kushtet e rritjes së aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe dhe në kushtet e rritjes së vazhdueshme të lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave e parave.

Në këtë kuadër, si dhe në bazë të V.K.M nr. 350 datë 23.05.2012, me datë 6 shkurt 2019, në Riad të Arabisë Saudite u nënshkrua nga palët Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Në zbatim të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërkombëtare, vijon procesi i ratifikimit, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga kjo marrëveshje e nënshkruar më parë prej saj .

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar duke u mbështetur në nenin 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin është miratuar në parim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 23.05.2012.

Relacion shpjegues për projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 30 nene, të cilët kryesisht konsistojnë në;

- Tatimet e përfshira (neni 2), që janë tatimet mbi të ardhurat, që vihen nga ana e Shteteve Kontraktuese, pavarësisht nga mënyra e mbledhjes së tyre.
- Përcaktimi i rezidencës tatimore të tatimpaguesit (neni 4) ku jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës (“banimit për efekt fiskal”) për individët dhe për personat juridikë.
- Përcaktimi i konceptit të “selisë së përhershme” të biznesit që një individ apo një sipërmarrje e njërit Shtet Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues (neni 5) dhe të ardhurat nga kjo “seli e përhershme” tatohen në shtetin ku ajo ndodhet apo ka vendin e saj fiks të biznesit (neni 7).
- Përcaktimi i të drejtës së plotë tatimore të tatimit mbi të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme (qeratë, apo të ardhura të tjera) për Shtetin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme (neni 6), pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit apo pronarit. Dispozitat e nenit do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.
- Trajtimi i të ardhurave nga transporti ndërkombëtar (neni 8) ku e drejta e plotë tatimore i jepet Shtetit ku ka rezidencën shoqëria ajrore apo detare që ushtron biznesin e transportit ndërkombëtar.
- Një rol të rëndësishëm në Marrëveshje ka lufta kundër të ashtuquajturit “transferim i çmimit” ose transferimi i fitimit. Në shumë raste kompanitë e të njëjtit grup multinacional (apo në përgjithësi personat e lidhur) bëjnë transferimin e fitimeve (nëpërmjet ndryshimit të çmimeve) në vende ku fitimet nuk tatohen apo tatohen me tarifa minimale. Në këtë rast, bazuar në dispozitat e nenit 9, nëse një Shtet Kontraktues përfshin në përfitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti - dhe taton sipas tyre - fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues duhej tatuar në Shtetin tjetër, dhe fitimet e përfshira janë fitime që do të ishin mbledhur nga ndërmarrja e Shtetit të parë të përmendur, nëse kushtet e vëna ndërmjet dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do t’u ishin vënë ndërmarrjeve të pavarura, atëhere

Shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm për shumën e tatimit të vënë mbi këto fitime. Në përcaktimin e këtyre rregullimeve, dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje do të konsiderohen në mënyrën e duhur dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultojnë njëri-tjetrin.

- Shmangia e tatimit të dyfishtë për të ardhurat nga dividendët, nga interesi dhe nga tatimi për liçenca (të ardhurat nga pronësia intelektuale – të drejtat e autorit, patentat), respektivisht nenet 10, 11 dhe 12, bëhet duke e ndarë të drejtën tatimore midis të dy vendeve, dhe konkretisht, vendi i burimit, pra vendi ku lindin këto të ardhura, ka të drejtë tatimore të kufizuar, ndërsa vendi i rezidencës (pra vendi ku është rezident individ apo kompania që i përfiton të ardhurat) krediton (redukon) tatimin e paguar në vendin tjetër kur llogarit detyrimin tatimor të tatimpaguesit.
- E drejta tatimore për tatimin e të ardhurave nga shitja e pronave të paluajtshme (neni 13) i takon vendit ku ndodhen këto prona të paluajtshme, pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit.
- Të ardhurat nga shërbimet personale të pavarura (neni 14), shërbimet profesionale që një resident i një shteti kontraktues realizon në shtetin tjetër do të tatohen në shtetin e rezidencës së individit që realizon këto të ardhura, përveç kur këto shërbime realizohen nëpërmjet një baze të qëndrueshme që ky individ ka në shtetin tjetër. Në një rast të tillë të ardhurat që i atribuohen kësaj baze të qëndrueshme do të tatohen në shtetin ku ndodhet baza e qëndrueshme.
- Të ardhurat nga shërbime personale të varura, tarifat e drejtuesve të kompanive, të ardhurat e artistëve dhe sportistëve, të ardhurat nga pensionet, etj., trajtohen veçmas në nenet 15-22.
- E drejta për tatimin e kapitalit (përfshirë tatimin mbi pronën), kur ky kapital konsiston në pronë të paluajtshme (neni 23), i takon shtetit kontraktues ku ndodhen këto prona.
- Nëpërmjet dispozitave të Nenit 24 jepen mënyrat dhe procedurat e përgjithshme për eliminimin e tatimit të dyfishtë.
- Neni 26 përcakton dispozitat e përgjithshme të shkëmbimit të informacionit.
- Neni 27 përcakton se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshje nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.
- Në nenin 29 jepen dispozitat e hyrjes në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit lidhur me plotësimin e procedurave ligjore të Qeverive të Shteteve Kontraktuese dhe të gjitha dispozitat e saj kanë efekt në të dy Shtetet Kontraktuese në lidhje me

tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 Janar ose pas 1 Janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës kur ka hyrë në fuqi Marrëveshja si edhe në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 Janari i vitit kalendarik pas vitit të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

- Në nenin 30 parashikohet se kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar, por secila nga palët, pas një periudhë prej 5 vjetësh nga hyrja në fuqi, mund të njoftojë palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfundimin e saj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji ju dërgua për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Ministria e Drejtësisë dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes u shprehën dakord me projektaktin. Gjithashtu, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme u shpreh dakord, por sugjeroi që në tekstin e projektvendimit të hiqet togefjalëshi “...për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë...”, sugjerim i cili u mor parasysh dhe u reflektua në projektvendim. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk u shpreh për projektaktin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk pritet të sjellë efekte në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Anila Denaj

Relacion shpjegues për projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin

